

AKT-THEMELUES
SHOQERISE TREGTARE "A1 HEALTH CARE AL" shpk

Ne mbështetje të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjeve në fuqi të Republikës së Shqipërisë, ortaku themelues :

2. **Znj. Arbnora Salihi**, e bija e Fitimit dhe Senadës, shtetase maqedonase, lindur në Shkup, më 04.06.1998, banuese në Ljuba Ivanovic 44/3-1 Shkup, Maqedonia e Veriut, identifikuar me Pashaportë nr. K1200447, madhore, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar sot me datë 10/11/2021 vendosi të miratojë Statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "A1 HEALTH CARE AL" shpk.

FORMIMI

NENI 1

Formohet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar e emërtuar "A1 HEALTH CARE AL" shpk. e cila do të funksionojë sipas ligjeve në fuqi dhe Statutit të Shoqërisë (ketu e më poshtë referuar si "Shoqëria").

SELIA DHE ADMINISTRATORI

NENI 2

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga 3 Vëllezerit Kondi, Vila nr. 129, Tiranë, Shqipëri. Cel. 0696841829. Email: idushi.is@gmail.com

Shoqëria do të administrohet nga Administratori i Vetëm i Shoqërisë **Znj. Arbnora Salihi** mandati i të cilës do të jetë jo më shumë se 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

KOHEZGJATJA

NENI 3

Veprimtaria e shoqërisë do të zgjaset për një kohë të pacaktuar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Ofrimi i shërbimeve ndaj kujdesit shëndetësor si më poshtë:

- Laborator mjekësor.
- Mjek të përgjithshëm me punë kujdestarie.
- Pediatri
- Repart të sindrom down
- Okulistik
- Mjekim i nevojshëm ditor në klinikë. etj.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) leke i përbërë nga n 1 (një) kuote. **Znj. Arbnora Salihi** zoteron 1 kuote me 100 (njëqind) % të kapitalit me vlerë nominale 100 (njëqind) leke.

NENI 6

Ndarja e fitimit do të jetë 100 (njëqind) përqind në favor të themeluesit të shoqërisë sipas pjesëmarrjes së kuotave.

NENI 7

Përsa nuk përcaktohet me siper, për bazë referimi do të meren ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë si dhe Statuti i shoqërisë.

NENI 8

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 kopje origjinale, në gjuhën Shqipe secila me vlerë të njëjtte ligjore. Hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga ortaku themelues i shoqërisë .

ORTAKU THEMELUES

Arbnora Salihi

